

Pd. 6858 / 17.5.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË  
11.05.2023

Me datë 11.05.2023, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Brisela Kadija, Diana Muriqi, Jona Leqejza, Sabahete Lishi, Vjollca Petani, Daniela Jakoja, Dhurata Tyli, Sabina Danaj, Donika Ndoja, Kristi Agnes Shllaku, Valbona Doniku, Suada Selimaj, Ornela Leka, Erion Metushi, Luan Heta, Elson Celiku Oltion Luli, Anton Kaftalli, Hilmi Lakti, Avenir Celaj, Marjan Ndershtiqaj, Sead Cocja, Gerald Hasaj, Lush Marku, Lulash Nika, Hekuran Gjorretaj, Anton Deda, Gjergj Sokoli, Nadir Spahija, Durim Bullakja.

Mbledhja hapet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Mars 2023"*.
2. Pr/Vendim: *"Për dhënie në përdorim pa kundërshpërblim, shoqërisë rajonale Ujëshjellës-Kanalizime Qarku Shkodër sh.a., një sipërfaqe prej 3350 m<sup>2</sup>, me nr.pasurie 5/250, vol.21, faqe 117, zona kadastrale 8593, në pronësi të Bashkisë Shkodër"*
3. Pr/ Vendim: *"Për kalimin e njetit ambulancë tek njësia vendore e kujdesit shëndetësor Shkodër, për qendrën shëndetësore Dajç"*
4. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2022, të Bashkisë Shkodër"*
5. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shkodër për vitet 2024-2026"*
6. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 për Bashkinë Shkodër"*
7. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqes 0.3201 ha, në ekonominë pyjore "Pruemos Sheldi" ngastra 104, nj.a. Gur i Zi, fshati Sheldi, për aktivitet instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 18 muaj për shoqërinë "Ëind Stream sh.p.k."*

8. Pr/ Vendim: "Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqes 0.3201 ha, në ekonominë pyjore "Pruemos Sheldi" ngastra 104, nj.a. Gur i Zi, fshati Sheldi, për aktivitet instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 12 muaj për shoqërinë "Voltalia Albanie".
9. Pr/ Vendim: "Për miratimin e kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje bari"
10. Pr/ Vendim: "Për miratimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe mënyrës së organizimit e funksionimit të tij në Bashkinë Shkodër"
11. Pr/ Vendim: "Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër" për vitin 2023"
12. Pr.Vendim: " Për miratimin e ndryshimit të emërimit të rrugës "GOLEMIT" në rruga "ARDIAN KODRA"
13. Pr.Vendim: " Për miratimin e ndryshimit të emërimit të rrugës "QAFJA BISHKAZHIT" në rruga "MARK NDOU"
14. Pr.Vendim: "Për miratimin e ndryshimit të rrugës "THAN" në rruga "PETRIT RUSHAJ" NJ.A.Pult".
15. Pr.Vendim "Për miratimin e ndryshimit nga sheshi "INDUSTRIA" në sheshi "RIZA RUSI"
16. Pr.Vendim: "Për miratimin e ndryshimit të rrugës "SHETITORJA E MOLOS" në rruga "OTTO VON HASBURG"
17. Pr.Vendim: "Për miratimin e emërimit të sheshit përpara stadiumit "LORO BORICI" me emrin "RAMAZAN RRAGAMI"
18. Pr.Vendim: "Për miratimin e emërimit të parkut pranë shëtitores së Molos me emrin "BUJAR QAMILI"
19. Pr.Vendim: "Për ndryshimin e një segmenti të rrugës "MARIN BICIKEMI" në rruga "MARTIRET KATOLIKE TE SHQIPERISE" në njësinë qytet (SHKODER)
20. Pr.Vendim: "Për miratimin e ndryshimit të emërimit të një segmenti të rrugës "RISTO SILIQI" në rruga "PAULIN NDOJA"
21. Pr.Vendim: "Për miratimin e ndryshimit të një segmenti të rrugës "DASHO SHKRELI" në rruga "ZAMIR SHPUZA"
22. Pr.Vendim: "Për miratimin e ndryshimit të rrugës "KISHA E KIRIT" në rruga At. "DEDE GJOKA"
23. Pr.Vendim: "Për miratimin e ndryshimit të emërimit të rrugës "MALIQ IDRIZI" në rruga "ALI HAKAJ"

24. Pr.Vendim: *“Për miratimin e ndryshimit të rrugës “PLANI” në rruga “BINAK ALIJA”*

25. Pr. Vendim: *“ Për emërtimin e ndryshimit të rrugës “ RINIA” në rruga “RROK NUSHI”*

26. Diskutime jashtë rendit të ditës

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, prandaj mbledhja deklarohet e hapur dhe kryetarja e këshillit mban fjalën e saj në mbledhjen e fundit të këshillit të këtij mandati 4-vjecar duke falenderuar të gjithë për punën e bërë dhe mbështetjen e dhënë.

Përpara se të hidhet në votim rendi i ditës, kryetarja propozon që pika e dytë të hiqet për arsye sepse duhet të shqyrtohet në komisionin përkatës para se të kalohet në vendimmarrje.

Znj.Danaj merr fjalën dhe kërkon të relatojë në lidhje me një çështje për ndryshimet klimaterike, e cila nuk ka nevojë për vendimmarrje.

Znj.Selimi në emër të grupit, kërkon që pas pikës së parë të rendit të ditës të kalojnë në shqyrtimin e pikës 12 dhe 13.

Kryetarja sqaron edhe se administrata e Bashkisë ka kërkuar një shtesë në rendin e ditës: *Pr.Vendim “Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit viti 2022, të Bashkisë Shkodër”.*

Z.Marku mendon që nëse pika 2. është nisëm e Këshillit bashkiak, komisioni i ligjeve duhet të dalë me një relacion dhe kjo pikë të mos shtyhet.

Kryetarja, Znj.Kadija sqaron se nuk është e mundur që kjo pikë të shqyrtohet sot në këtë mbledhje.

Z.Deda ka një pyetje për zv.Kryetarin. Ai shprehet se është e disata herë që në mbledhjet e këshillit vijnë projekt vendime për emërtesa rrugësh, ndërkohë që kërkesa nga familjarët e sportistit të ndjerë Z.Shatku vazhdon të mbetet në sirtar.A ka një përgjigje për këtë?

Z.Vukaj, si anëtar i komisionit të ligjeve po ashtu shprehet në lidhje me propozimin e Z.Marku se është e pamundur të dilet me një relacion në lidhje me pikën 2., prandaj ai është dakort me shtyerjen e kësaj pike.

Z.Kaftalli propozon që emërtesat e rrugëve dhe ndryshimet të shqyrtohen njëherazi dhe të diskutohet vetëm për ato që ka vërejtje.

Znj.Kadija shprehet se mund të relatohen njëherazi por votimi duhet të bëhet ndaras.

---

Hidhet në votim rendi i ditës me propozimet e bëra për ndryshime, ku rezultojnë 28 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

### Miratohet

1.Mbledhja vijon me Pr/Vendimin *“Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Mars 2023”.*

Zv.Kryetari Z.Dedaj mban fjalën e tij në mbledhjen e fundit të këtij mandati dhe relaton shkurtimisht sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 29 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

### Miratohet

Fjala merret nga Znj.Danaj, e cila relaton mbi materialin e përgatitur në lidhje me ndryshimet klimaterike që ndikojnë në vendin tonë dhe falenderon të gjithë për punën e kryer gjatë këtij mandati.

2.Vijohet me pikën 3. të rendit të ditës Pr/ Vendim “Për kalimin e mjetit ambulancë tek njësia vendore e kujdesit shëndetësor Shkodër, për qendrën shëndetësore Dajç”

Kourumi i domosdoshëm nuk është prezent në sallë, prandaj kjo pikë duhet të shtyhet.

3.Vijohet me pikën 12,13. të rendit të ditës: Pr.Vendim: “ Për miratimin e ndryshimit të emërimit të rrugës “GOLEMIT” në rruga “ARDIAN KODRA” dhe Pr.Vendim:“ Për miratimin e ndryshimit të emërimit të rrugës “Qafa BISHKAZHIT” në rruga “MARK NDOU”, të cilat relatohen nga Z.Dedaj së bashku sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Projekt akti i 12. hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

### Miratohet

Projekt akti i 13.hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

### Miratohet

4.Vijohet me pikën tjetër Pr/ Vendim: “Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2022, të Bashkisë Shkodër”

Përsëri fjala për Z.Dedaj, i cili relaton shkurtimisht sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës. Kourumi i domosdoshëm nuk është prezent në sallë, prandaj kjo pikë nuk mund të hidhet në votim.

Znj.Leqejza propozon që të relatohet edhe për pikën tjetër të buxhetit meqënëse janë të së njëjtës natyrë, por Znj.Kadija shprehet se nëse kourumi i domosdoshëm nuk është prezent atëherë mbledhjen duhet ta deklarojë të mbyllur.

*Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 11.05.2023. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).*

*Procesverbali përmban 4 faqe*

*Sekretar*

